

pranuar nuk janë shoqëruar me marrjen e masave konkrete nga institucionet shtetërore shqiptare, për të njohur të drejtat e ligjshme të kësaj shtrese¹.

Në këtë rekomandim do të përmbledhim shqetësimet e institucionit tonë në lidhje me 4 aspekte të këtij procesi e gjegjësisht: pagesës efektive të dëmshpërblimit, rrethet e trashëgimtarëve, premisat ligjore, si dhe detyrimin për nxjerrjen e akteve nënligjore.

Në institucionin tonë janë regjistruar dhe trajtuar një sërë ankesash të ish të përndjekurve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre, kryesisht, por jo vetëm, për përfitimin e dëmshpërblimit të parashikuar në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar. Po ashtu, me iniciativën e vetë ekspertëve të institucionit është nisur hetimi administrativ për disa çështje lidhur me të drejtat e ish të përndjekurve politikë.

Nga ana jonë, për shkak të ndjeshmërisë publike të kësaj çështjeje, është parë me interes dhe e arsyeshme regjistrimi dhe ndjekja me iniciativë e monitorimit në përgjithësi të procesit të dëmshpërblimit të shtresës së ish të përndjekurve politikë.

Kështu, është konstatuar në media, konkretisht në gazetën “Panorama” të datës 17 shkurt 2021 se është publikuar një listë e dytë, ku përfshihen trashëgimtarët e të dënuarve politikë që marrin këstin e tretë të dëmshpërblimit.

Ndërkohë në një artikull të kësaj gazete, zoti B.N, President i Unionit Mbarëkombëtar i të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, është shprehur se ritmet e dhënies së kësteve janë tepër të vonuara në kohë dhe do të bëjnë që të largohen nga jeta edhe brezi i tretë i trashëgimtarëve.

Një shqetësim i ngjashëm është ngritur edhe nga Kryetari i shoqatës së ish të përndjekurve politikë dega Shkodër, Z.D, lidhur me shtyrjen e dhënies së këstit të tretë të dëmshpërblimit për ish të përndjekurit politikë.

Në kuadër të hetimit administrativ të nisur nga ana jonë, është kërkuar informacion pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, mbi fondin e vënë në dispozicion për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë për vitet 2020 dhe 2021, numrin e dosjeve që

¹ Nr.K2/TH3-2 prot., datë 25.09.2020 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

Nr.K2/H10-4 prot., datë 30.12.2020 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

Nr.K2/B1-2 prot., datë 07.01.2021 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Nr.K2/D4-2 prot., datë 30.07.2021 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Nr.K2/I13-2 prot., datë 24.12.2021 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

janë proceduar për dhënien e kështit të tretë, personat përfitues gjatë vitit 2020 dhe sa dosje parashikohet të procedohen gjatë vitit 2021.

Me shkresën nr.6127/1 prot., datë 13.04.2021 në kthimin e përgjigjes Ministria e Financave dhe Ekonomisë paraqet këto të dhëna si vijon:

“Në zbatim të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është autoriteti përgjegjës për shpërndarjen e dëmshpërblimit, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit.

Për shpërndarjen e kësteve të radhës, Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve i referohet Udhëzimit nr.5 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, datë 15.04.2016 “Procedurat e përlllogaritjes së përfitimeve nga ligjet e mëparshme dhe të pagesave të dëmshpërblimit për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, ku citohet se: “Shqyrtimi juridik dhe kalimi për pagesë i dosjeve për kështin e radhës realizohet në bazë të radhës kronologjike të përfitimit të kështit të parë”.

Deri në muajin prill, Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve ishte duke shpërndarë dëmshpërblim financiar për dosjet e ish të dënuarve politikë deri në radhën e pagesës nr.250.

Nga ana tjetër, numri i subjekteve përfituese të parashikuara dhe procesuara deri në fund të vitit buxhetor, është në varësi të fondit total të miratuar dhe dorëzimit të dokumentacionit nga ana e subjekteve përfituese.

Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë bën me dije se fondi i miratuar për kategorinë e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist për vitin 2020 ka qenë 1 miliard lekë.

Gjithashtu, për vitin 2020 numri i subjekteve përfituese të parashikuara dhe publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka qenë 9048 individë për të dy kategoritë e legjislacionit në fuqi, ku vetëm për 8518 subjekte përfituese është depozituar dokumentacion dhe për rrjedhojë janë procesuar për pagesë nga ana jonë, duke e ezauruar fondin në mënyrë të plotë.

Fondi i miratuar për kategorinë e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist për vitin 2021 është 1 miliard lekë. Numri i dosjeve të parashikuara për t’u procesuar me fondin aktual të vitit 2021 në dispozicion është 1827 dosje e përkthyer kjo në 10218 subjekte përfituese (individë) në total.”

Në përmbushje të mandatit të tij kushtetues, Avokati i Popullit ka qenë dhe mbetet i angazhuar në misionin e tij të mbrojtjes, garantimit dhe promovimit të të drejtave të njeriut.

Në këtë fokus, përfshihen edhe të drejtat e ish të dënuarve politikë apo të të afërmeve të tyre që vijojnë të vuajnë pasojat e rënda të ish-regjimit diktatorial. Në këtë kuadër, një rëndësi të veçantë merr edhe drejtësia tranzitore, si një proces shumëdimensional, në të cilin duhet të ecet paralelisht në të gjitha drejtimet.

Shekulli i XX njihet edhe si “periudha e ekstremeve”², e karakterizuar nga krimet më të rënda kundër njerëzimit, luftërat, tirania, por edhe nga lëvizjet për demokratizim dhe liberalizim. Pyetjet mbi mënyrën “e duhur” për t’u përballur me këto krime, tranzicionet e suksesshme, mënyrat për të vendosur paqe të qëndrueshme dhe siguri në situatë post-konflikti, kanë marrë një rëndësi të veçantë. Në këtë kontekst lindi edhe koncepti i **“Drejtësisë Tranzicionale”**, dhe që tashmë ka marrë një rëndësi globale. Drejtësia Tranzicionale, sipas Buckley-Zistel, i referohet *“instrumenteve dhe përpjekjeve për t’u përballur me të kaluarën pas një konflikti apo regjimi të dhunshëm dhe që bëjnë të mundur tranzicionin drejt një shoqërie të qëndrueshme në paqe dhe më demokratike”*.

Ky term u përdor për herë të parë në vitet ‘90, koha e transformimeve globale të pas Luftës së Ftohtë. Termi buron nga lëvizjet e të drejtave të njeriut dhe koncepti fillestar i referohej ndjekjes penale të shkeljeve së të drejtave të njeriut të kryera nga regjimet e kaluara diktatoriale dhe shtypëse. Përveçse për të mbajtur gjallë një punë të rëndësishme akademike, ideja e drejtësisë tranzicionale u përshtat dhe u përvetësua gjatë dy dekadave të fundit nga organizatat ndërkombëtare, komuniteti i ndërtuesve të paqes (peace-building) dhe të drejtave të njeriut. Si rrjedhojë, kuptimi i këtij termi u zgjerua për t’u bërë ombrellë për një shumëllojshmëri instrumentesh, mekanizmash dhe masash që shkojnë përtej aspektit ndëshkues të përballjes me të kaluarën.

Sot, koncepti i drejtësisë tranzicionale karakterizohet nga lidhja e ngushtë mes fazës së tranzicionit dhe realizimit të drejtësisë. Kjo e fundit nuk duhet kuptuar vetëm në aspektet juridike. Koncepti përçon idenë se paqja dhe siguria mund të vendosen në vend, vetëm kur krimet e mëparshme të luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të adresohen nëpërmjet mekanizmave të përshtatshëm. Vetëm «një sqarim i plotë i padrejtësive të së shkuarës» parandalon që e kaluara të bëhet barrë për të ardhmen. Vetëm një shkëputje prej saj bën të mundur “parandalimin e krimeve të ardhshme, krijimin e besimit në një formë të re qeverisëse dhe arritjen e pajtimit të palëve në konflikt”. Me kalimin e kohës është zhvilluar një shumëllojshmëri instrumentesh që merren me të kaluarën, me qëllim parandalimin dhe mos përsëritjen e krimeve dhe konflikteve.

Më të rëndësishmet ndër to janë:

- ndjekja penale nga gjykatat kombëtare dhe ndërkombëtare;
- kërkimi i së vërtetës p.sh. ekspozimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut përmes komisioneve të së vërtetës (truth commissions);

² Për më tepër:

https://www.nurembergacademy.org/fileadmin/media/pdf/publications/Drejtasia_TranzicionaleVersioni_FINAL.pdf

- dëmshpërblimi (reparations) për viktimat në formë rehabilitimi; kompensimi (financiar apo material) dhe kthimi (të pasurive);
- reformat institucionale (veçanërisht ato në gjyqësi, polici dhe ushtri) dhe largimi i autorëve, veçanërisht të elitave të vjetra nga poste të rëndësishme shoqërore; dhe
- përkujtimi p.sh. nëpërmjet ngritjes së përmendoreve dhe muzeve.

Ky proces me funksion lehtësues dhe efektiv në stabilizimin dhe pajtimin e konflikteve që linte të hapura ndryshimi i sistemeve, do të ishte drejtësi tranzicionale. Kësaj rruge iu futën pjesa më e madhe e vendeve që dolën nga komunizmi, përfshirë këtu edhe Shqipëria. Por si një vend që doli vonë nga diktatura, Shqipëria nuk ka ecur me ritmet e duhura në këtë drejtim. Ashtu sikurse pjesa më e madhe e përpjekjeve për një tranzicion serioz qoftë ekonomik, po ashtu edhe politik, procesi i drejtësisë tranzicionale në Shqipëri “u krye me gabime dhe në pjesën më të madhe të kohës që një dështim”³. Në Shqipëri mund të cilësohen “dy faza të politizuara të drejtësisë tranzicionale: periudha 1991-1997 me nisjen e këtij procesi dhe periudha pas vitit 1997 me braktisjen e plotë të tij”⁴. Periudha prej vitit 1991 deri në 1997, megjithë përpjekjet që u bënë, rezultoi në një proces të ç’organizuar, të politizuar dhe të pasuksesshëm.

Përvoja e vendeve post-komuniste në demokraci të reja ka treguar se procesi i reagimit mbi të kaluarën diktatoriale është nyja kryesore për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe legjitim konform vlerave dhe parimeve demokratike. Për këto vende, përballja me të shkuarën ishte veçse fillimi. Vënia përpara drejtësisë të atyre që shkelën të drejtat e njeriut, mundësimi i politikave lehtësuese dhe ndihmëse për të përndjekurit, si dhe reformimi i institucioneve publike në të atillë formë që të mund të parandalojnë ripërsëritjen e shkeljeve të së kaluarës, ishin disa nga hapat e këtij procesi⁵.

Gjatë periudhës rreth gjysmë shekullore regjimi diktatorial në Shqipëri ekzekutoi, internoi dhe burgosi, për arsye politike, dhjetëra mijëra shqiptarë në burgjet dhe kampet e internimit në mbarë vendin. Persekutimi komunist ishte më i përhapur në vendet e vuajtjes së dënimit, në burgje dhe në kampet e internimit, ku të ndëshkuarit vuajtën nga torturat më të rënda, në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe të ligjit ndërkombëtar humanitar.⁶

³ Austin C. Robert and Ellison, Jonathan (2009): Albania. In: Lavinia Stan (Ed): Transitional Justice in Eastern Europe and the Former Soviet Union. Reckoning with the communist past (fq. 176-200). NY: Routledge

⁴ Periudha prej vitit 1991 deri në 1997, megjithë përpjekjet që u bënë, rezultoi në një proces të ç’organizuar, të politizuar dhe të pasuksesshëm.

⁵ <https://idmc.al/assets/idmc-mos-rehabilitimi-i-ish-te-perndjekurve-politike.pdf>

⁶ Sipas të dhënave zyrtare nga institucionet e Shqipërisë, gjatë regjimit komunist 59.009 shqiptarë u internuan në kampe përqendrimi, 7.022 humbën jetën gjatë internimit, 34.135 shqiptarë u burgosën si të dënuar për arsye politike, 984 shqiptarë kanë vdekur në burgjet e regjimit, 6.027 shqiptarë janë vrarë gjatë regjimit komunist në Shqipëri, ndërsa rreth 6.000 rezultojnë si të zhdukur.

Pasi kanë kaluar mbi 30 vjet nga shembja e sistemit komunist në Shqipëri, shoqëria shqiptare është ende e ndjeshme ndaj kësaj periudhe të errët në historinë e saj.

Pavarësisht parashikimeve të ligjit nr.7514, datë 30.09.1991, i ndryshuar, "*Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë*", rehabilitimi i ish-të përndjekurve politikë duhet të kishte përfunduar, por për fat të keq, kjo shtresë vijon të mbetet e marginalizuar dhe problem thelbësor i shoqërisë shqiptare.

Në ligjin nr.7748, datë 29.07.1993 "*Për Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist*" përcaktohet detyrimi ligjor dhe moral i shtetit për zbatimin e ligjit e të drejtën për kompensim të kësaj kategorie dhe fillimisht ligji parashikonte se procesi i kompensimit do të plotësohej në fund të vitit 1994. Po ashtu, ligji garantonte lehtësitë dhe përparësitë për kërkesat individuale dhe kolektive në fushat e mëposhtme ekonomike, financiare dhe veprimtaritë sociale: në fushën e privatizimit të pronës shtetërore; dhënies së kredive; ndërtimit dhe strehimit; turizmit, arsimimit dhe kualifikimit punësimit brenda dhe jashtë vendit; përmbushjes së programeve të ndryshme ekonomike dhe sociale kombëtare dhe ndërkombëtare; si dhe në fushën e shëndetit publik.

Pavarësisht se trajtimi i dëmshpërblimit dhe kompensimit pasuror të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga regjimi komunist, fillimisht buron nga ligji nr.7514, dt. 30.09.1991 "*Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë*", i ndryshuar, saktësohet dhe rregullohet në mënyrë më të plotë në ligjin "*Për Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist*", ku përcaktohet kuptimi i kompensimit pasuror të këtyre personave si një shpërblim i menjëhershëm me të holla, pensioni jetësor, kompensim rroge, tokë, lokal dhe forma të tjera përfitimi material, të cilat do t'i jepen personit të përndjekur ose familjes së tij kur ai ka vdekur, pa kthim, në kompensim të jetës, humbjes së lirisë, punës së papaguar dhe vuajtjeve, duke pasur si qëllim kryesor krijimin e kushteve dhe të mundësive për një integrim sa më të shpejtë të tij dhe të familjes së tij në jetën normale ekonomiko-shoqërore të vendit tonë.

Masat për dëmshpërblimin material përbëjnë veprime të cilat shpesh kuptohen në mënyrë jo të qartë. Rehabilitimi i referohet procesit të rikthimit të një personi në pozitën (personale, profesionale, etj.) që ka patur përpara fillimit të regjimit represiv. Ndërsa, dëmshpërblimi i referohet masave që ofrojnë kompensime të cilat zakonisht marrin formën e paketave të përfitimeve, zhdëmtimeve dhe pagesave të veçanta.

Duke krahasuar dhe analizuar realizimin e masave të përcaktuara në kuadrin ligjor, shpesh nga neglizhenca në hartimin dhe mosnxjerrja në kohë e akteve nënligjore nga organet shtetërore, për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në ligjet e mësipërme, ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë, nuk kanë përfituar plotësisht dhe në kohë nga zbatueshmëria e plotë e kuadrin ligjor dhe për rrjedhojë janë krijuar pasoja serioze në rehabilitimin e tyre. Nga institucionet shtetërore përgjegjëse, jo vetëm që nuk janë realizuar detyrimet ligjore

ndaj shtresës së ish-të dënuarve, por evidentohet se nuk as një afat apo datë të saktë apo të parashikueshme se kur do të mbarojë procesi i plotë i dëmshpërblimit, duke shtyrë kështu për një periudhë të pacaktuar e të tejzgjatur rehabilitimin e kësaj shtrese të shoqërisë.

Në vitin 2007, u miratua ligji nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, në zbatim të të cilit janë nxjerrë edhe aktet nënligjore, me qëllim miratimin e skemës së shpërndarjes për kompensimin e ish të dënuarve politikë të komunizmit.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se përqindja e planifikuar çdo vit në buxhetin vjetor për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë rezulton në nivel të pamjaftueshëm për përfundimin e këtij procesi brenda një kohe optimale, por do të vijojë të zvarritet në vite, **duke mos u realizuar brenda afateve të arsyeshme.**

Legjislacioni për të drejtat e të përndjekurve politikë ka pësuar ndryshime të njëpasnjëshme, duke ndryshuar edhe procedurat e dhënies së dëmshpërblimit për të përndjekurit. Me ndryshimet e vitit 2014 në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist” u aplikua një skemë kategorizuese prioritarizimi si parësor dhe joparësor, duke i ndarë fondet me një raport 70% për kategorinë e përfituese parësorë me 30% për kategorinë e subjekteve përfitues joparësorë. Ndërsa fondi i vënë në dispozicion nga qeveria nuk ishte kurrësesi i mjaftueshëm.

Iniciativat e ndërmarra disa herë nga ekzekutivi me qëllim ndryshimin e procedurave, e kanë ndërlikuar shpeshherë procesin dhe përsëri akoma nuk ka një afat përfundimtar të plotësimi të detyrimit të shoqërisë shqiptare për finalizimin e dëmshpërblimit për ish-të dënuarit e të përndjekurit dhe trashëgimtarët e tyre. Vlen të theksohet fakti se gjendja sociale në të cilën ndodhet aktualisht kjo kategori nuk është një gjendje për t'u marrë si model, por një gjendje varfërie.

Këshilli i Evropës i ka kushtuar vëmendje të veçantë kësaj çështjeje, duke miratuar një sërë aktesh në këtë fushë sikurse mund të përmendim: Rezoluta nr.1096 e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (KE) “Për masat për të çrrënjësuar trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste”, në vitin 1996⁷; Deklarata e Pragës “Mbi ndërgjegjen evropiane dhe komunizmin” (2008) që përcaktonte angazhimin për të dënuar krimet e komunizmit, sipas praktikës së Gjyqit të Nyrenbergut, si krime kundër njerëzimit; Dëgjesa Publike Evropiane mbi “Krimet e Kryera nga Regjimet Totalitare” (2008) dhe të Asamblesë Parlamentare të KE mbi “Domosdoshmërinë për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste” (2006) etj.

⁷ “Reziqet e një procesi tranzicioni të dështuar janë të shumta. Në rastin më të mirë në vend të demokracisë do të mbretërojë oligarkia, në vend të ligjit, korrupsioni dhe në vend të të drejtave të njeriut krimi i organizuar”.

Përmes këtyre rezolutave, Këshilli i Evropës u kërkonte qeverive postkomuniste të distancoheshin qartësisht nga krimet e regjimeve komuniste totalitare dhe t'i dënonin ato pa asnjë ambiguitet. Këto dokumente kanë qenë të njohura edhe për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, i cili në tetor të vitit 2006, miratoi Rezolutën e vetme në historinë e tranzicionit shqiptar mbi dënimin e krimit komunist, në tekstin e së cilës reflektohen *parimet se njohja dhe denoncimi i krimeve të diktaturës komuniste i shërbejnë shmangies së përsëritjes së krimeve të ngjashme në të ardhmen, duke theksuar domosdoshmërinë e ndëshkimit të krimeve të kryera dhe rivlerësimin real të historisë si një faktor vendimtar në edukimin e brezave të rinj.*

Pavarësisht kësaj, Rezoluta e 30 tetorit 2006 është lënë në harresë, duke na treguar se ballafaqimi me të shkuarën nuk ka qenë dhe nuk është më prioritet serioz i politikbërjes sonë.

Ka qenë një interes i vazhdueshëm i gjithë shoqërisë shqiptare pas viteve '90-të për të pasur një trajtim më të hollësishëm të kalvarit komunist dhe sistemit në të cilin shqiptarët jetuan për një kohë të gjatë.

Shteti shqiptar përmes rivendosjes së një shoqërie të lirë dhe demokratike, ka marrë përsipër kundrejt shtetasve të tij angazhimin për krijimin e një sistemi ligjor në mbrojtje të të drejtave themelore të njeriut, ku shtetasve shqiptarë t'u jepet garancia e ushtrimit të këtyre të drejtave.

Përveç njohjes së të drejtave për këtë kategori, ato duhet të realizohen efektivisht nga shteti, **brenda afateve të arsyeshme**, dhe jo thjesht të deklarohen. Duhet bërë i mundur përshpejtimi i dhënies së përfitimeve/dëmshpërblimeve për shtresën e ish të përndjekurve politikë, duke vënë në vend të drejtat e shkelura dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së kësaj kategorie. Ky proces tashmë 30 vjeçar po e bën të paarrtshme këtë të drejtë, për sa një pjesë e mirë e personave që kanë vuajtur në atë regjim po moshohen e rrjedha e ciklit të jetës është e paevitueshme. Procesi i planifikimit të kësaj vlere ndër vite duhet të kish qenë i tillë që procesi të kishte përfunduar, por ende edhe sot mbetet e paqartë se kur do të përfundojë.

Sikurse jeni në dijeni, katër vitet e fundit, fondi i parashikuar për këtë kategori ka ardhur duke u ulur, gati është përgjysmuar. Për më tepër, në Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2019, KLSH ritheksonte:⁸

“Konstatohet se vlera e detyrimit të njohur nga shteti shqiptar dhe i papaguar për ish të përndjekurit politikë deri në fund të vitit 2019 është 33,182 milionë lekë. Nëse buxhetimi i

⁸ Për më tepër, shih linkun si vijon:

Po ashtu kjo theksohet edhe në Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2020 linku si vijon:
<https://panel-klsh.almotech.co/storage/phpbuokI4.pdf>

këtij fondi do të vazhdojë me këtë ritëm, ky detyrim do të mund të shlyhet pas rreth 32 vitesh.

Në përgjigje të rekomandimit tonë Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.23315/1, datë 21.01.2022 shprehet se vlerëson dhe merr në konsideratë çdo rekomandim të dërguar nga institucioni i Avokatit të Popullit, por realizon lëvrimin e kësteve në varësi të fondit që miratohet për secilin vit buxhetor. Gjithashtu, me anë të kësaj shkrese informohemi se fondi i miratuar për kategorinë e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, për vitin buxhetor 2022 është **vetëm 1 miliard lekë.**

Për këtë arsye, paraqet domosdoshmëri rishikimi i këtij fondi për vitet buxhetore në vijim.

Nisur nga ankesa e paraqitur nga shtetasja H.B lidhur me kërkesën për të përfituar dëmshpërblim sipas ligjit për vrasjen e “Dëshmorit të Demokracisë”, B.B, e cila edhe pse ka depozituar dokumentacionin në Ministrinë e Drejtësisë në vitin 2013, nuk e ka përfituar këtë të drejtë. Ndërkohë, kur familjet e tjera të dëshmorëve të 2 prillit i kanë përfituar këto dëmshpërblime.

Kjo çështje nga ana jonë është adresuar në Ministrinë e Drejtësisë ku janë kërkuar sqarime, mbështetur në pikën 4 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, në shkronjat b dhe c të nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Në kthimin e përgjigjes së kësaj ministrie referohet sa më poshtë:

“Në bazë të nenit 19, të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, është përcaktuar afati për dorëzimin e kërkesave për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë brenda datës 01.07.2009. Mosparaqitja e kërkesës brenda afatit të përcaktuar, sjell humbjen e së drejtës së dëmshpërblimit për ish të dënuarin politik apo familjarët e viktimave të pushkatuara. Sipas këtij ligji, ish i dënuari politik i regjimit komunist, kujdestari i tij ligjor apo familjari i viktimës së pushkatuar, nuk mund të rivendosen në afat për paraqitjen e kërkesës.

Me ndryshimet ligjore përkatëse sipas ligjit nr.27, datë 23.03.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, u përcaktua afati për dorëzimin e kërkesave për dëmshpërblim deri më datë 31.12.2017, vetëm për aplikimet e paraqitura nga ish të dënuarit politikë, të cilët bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve përfituese parësore.

Nga verifikimet e kryera kërkesa e shtetasit A.D për “Dëshmorin e Demokracisë” B.B është paraqitur jashtë afateve ligjore, konkretisht në datë 23.04.2013, për rrjedhojë nuk mund të merret në shqyrtim nga Ministria e Drejtësisë.”

Sipas VKM nr.419, datë 14.04.2011 “Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, **të ndryshuar**, pika 7 përcakton këtë radhë përparësie:

“Shpërndarja e dëmshpërblimit, për subjektet përfituese të kategorisë parësore, për të njëjtin këst, do të kryhet sipas kësaj radhe:

- a) Ish - të dënuarat politike gra që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës;*
- b) Ish - të dënuarit politikë që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës dhe që kanë moshën mbi 75 vjeç, me hyrjen në fuqi të këtij ligji;*
- c) Ish - të dënuarit politikë, të cilët vuajnë sëmundje të rënda, sipas përcaktimit të aktit nënligjor të posaçëm;*
- ç) Ish të - dënuarit politikë që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës, të cilët, pavarësisht moshës, kanë pasardhës të radhës së parë në moshë të mitur, me hyrjen në fuqi të këtij ligji;*
- d) Ish - të dënuarit politikë që nuk jetojnë dhe që kanë trashëgimtarë të radhës së parë, të cilët janë në moshë të mitur me hyrjen në fuqi të këtij ligji;*
- dh) Ish - të dënuarit politikë që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës dhe që kanë moshën nën 75 vjeç me hyrjen në fuqi të këtij ligji.”*

Sa më sipër, vërehet se sfera e subjekteve përfitues të përcaktuar në ligj është shumë e ngushtë, pasi është e pamundur të përfitojnë vetëm ata subjekte të parashikuar sipas VKM nr.419, datë 14.04.2011. Për më tepër, është diskriminuese për kategoritë e tjera që nuk përfitojnë të drejtat e tyre të njohura nga ligji.

Gjithashtu, afati prekluziv i përcaktuar në ndryshimin ligjor “**deri më datë 31.12.2017, vetëm për aplikimet e paraqitura nga ish të dënuarit politikë, të cilët bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve përfituese parësore**”, është në dëm të interesave për përfitimin e kësaj kategorie.

Është fakt i njohur se një pjesë e madhe e shtresës së të përndjekurve ose kanë humbur jetën gjatë viteve të tranzicionit, ose vuajnë nga probleme shëndetësore, ose për shkak të rrethanave të ndryshme objektive, nuk kanë marrë informacionin e duhur për paraqitjen e dokumentacionit dhe përmbushjen e kriterëve për përfitim.

Për këtë arsye, strukturat shtetërore duhet të jenë mirëkuptuese dhe t’ju vijnë në ndihmë këtyre njerëzve pas vuajtjeve të shkaktuara nga një regjim diktatorial, në shkelje të plotë të drejtave themelore.

Institucioni i Avokatit të Popullit është njohur në vitin 2020 edhe me propozimet për ndryshime në disa dispozita të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar (iniciativë deputeti). Në këtë kuadër, kemi paraqitur edhe mendimet tona lidhur me ndryshimet e propozuara.

Nga ana jonë, është vlerësuar kjo iniciativë për të zgjeruar objektin e ligjit edhe për dëmshpërblimin e familjarëve të viktimave "*të ekzekutuara pa gjyq*" si dhe ndryshimin e periudhës së vuajtjes së persekutimit komunist nga "*gjatë periudhës 30.11.1944 deri në 1.10.1991*" në "*gjatë periudhës 08.11.1941 deri në 01.10.1991*", edhe pse ende rezultoi pamiratur nga Kuvendi i Shqipërisë.

Edhe pse kjo shtresë e shoqërisë dhe familjarët e tyre kanë vuajtur mjaftueshëm gjatë regjimit komunist dhe një pjesë e mirë e tyre janë në moshë të thyer, me probleme shëndetësore dhe ekonomike, është detyrim i shtetit shqiptar të dëmshpërblejë vuajtjet dhe sakrificat e tyre.

Vlerësojmë se ndryshimi i objektit në nenin 1 dhe zgjerimi i subjekteve përfituese të ligjit, duhet të shoqërohet edhe me ndryshimin e nenit përkatës në lidhje me afatin e paraqitjes së kërkesave para autoritetit (Ministrit të Drejtësisë), për t'u dhënë mundësinë e përfitimit të dëmshpërblimit.

Ndaj, sugjerojmë që:

Në nenin 19 "**Afati i paraqitjes së kërkesës dhe autoriteti**", pika 1, të bëhet ndryshimi i datës së dorëzimit të kërkesave/aplikimeve për dëmshpërblim për ish të dënuarit politikë apo familjarët e viktimave të pushkatuara, duke përcaktuar një afat të ri, për t'u dhënë mundësinë e aplikimit të përndjekurve dhe trashëgimtarëve të tyre që nuk kanë aplikuar deri tani, për shkak të afatit prekluziv ekzistues.

Po kështu në pikën 2 të nenit 19 të bëhet ndryshimi, duke krijuar mundësinë për personin e autorizuar apo kujdestarin e tij ligjor që të mund të rivendoset në afat.

Çmohet se ky afat i ri i paraqitjes së kërkesave duhet të jetë i vlefshëm jo vetëm për dëmshpërblimin e familjarëve të viktimave "*të ekzekutuara pa gjyq*", por për të gjithë subjektet e parashikuara në ligj. Kjo, nisur nga trajtimi i deritanishëm nga institucioni ynë i problematikave që shqetësojnë një numër të konsiderueshëm të kësaj shtrese e që kanë të bëjnë me mosparaqitjen e kërkesave për dëmshpërblim brenda afatit ligjor të parashikuar në ligj, i cili fillimisht ka qenë data 01.07.2009 e pas ndryshimeve ligjore të pësuara në vitin 2017, ky afat ishte 31.12.2017.

Mosparaqitja e kërkesave ka ardhur për arsye nga më të ndryshmet sikurse mund të përmendim, mosnjohjen e ligjit lidhur me afatin e paraqitjes së kërkesave/aplikimeve, vështirësitë për gjetjen e dokumentacionit përkatës, largimi i disa shtetasve, pjesë e

kategorisë së subjekteve përfituese jashtë shtetit shqiptar, etj. Ndërkohë ligji ka parashikuar se mosparaqitja e kërkesës brenda afatit të përcaktuar, sjell humbjen e të drejtës së dëmshpërblimit për ish të dënuarin politik apo familjarët e viktimave të pushkatuara. Përveç kësaj ligji ka parashikuar se ish i dënuari politik, kujdestari i tij ligjor, apo familjarët e viktimës së pushkatuar nuk mund të rivendosen në afat për paraqitjen e kërkesës, duke e bërë afatin afatin prekluziv.

Gjithashtu, një shqetësim tjetër që kemi konstatuar gjatë shqyrtimit të ankesave të bëra nga individë të kësaj shtrese përfaqësues të kategorisë “internim/dëbim”, është ai i mosmarrjes së dëmshpërblimit sikurse parashikohet në nenin 6, gërma “c” të këtij ligji. Theksojmë se, ndonëse kanë kaluar **mbi 12 vjet** që ligji ka hyrë në fuqi, ende nuk është nxjerrë VKM-ja për miratimin e skemës së pensionit të veçantë për të internuarit dhe dëbuarit gjatë regjimit komunist.

Efektivisht, mospërmbushja e këtij detyrimi ligjor identifikon jo vetëm shkelje të parashikimeve ligjore, por edhe shkelje të së drejtës së ligjshme të individëve përfaqësues të këtyre kategorive të të dënuarve politikë nga regjimi komunist, për t’u trajtuar me dëmshpërblim sipas parashikimeve të ligjit “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar.

Pra, ndonëse ligji i njuh të drejtën e trajtimit me dëmshpërblim këtyre kategorive, ai nuk po gjen zbatim, në kushtet kur nuk është nxjerrë akti nënligjor specifik me të cilin rregullohet kjo situatë, me qëllim që individët e internuar dhe të dëbuar, të mos ndihen të diskriminuar nga pjesa tjetër e përfituesve të parashikuar nga ligji.

Sqarojmë se lidhur me këto problematika Institucioni i Avokatit të Popullit ka reaguar duke bërë disa rekomandime gjatë viteve 2013 dhe 2019 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Këshillit të Ministrave. Evidentojmë faktin se këto rekomandime nuk kanë gjetur zbatim. Sjellim në vëmendje se rekomandimi i fundit drejtuar të tre institucioneve të cituara më sipër është bërë në datën 22.10.2019.

Vlerësojmë se mospërmbushja e këtij detyrimi ligjor nga shteti identifikon jo vetëm shkelje të parashikimeve ligjore, por edhe shkelje të së drejtës së ligjshme të individëve përfaqësues të kësaj shtrese të të dënuarve politikë të regjimit komunist, për t’u trajtuar me dëmshpërblim sipas parashikimeve të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar.

Për këtë arsye, sugjerojmë që ne nenin 6 gërma “c” e këtij ligji të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“c) për personat e tjerë të internuar ose të dëbuar, masa e dëmshpërblimit është 500 (pesëqind) lek në ditë”;

E vlerësojmë këtë masë dëmshpërblimi proporcionale duke u nisur nga mënyra e vuajtjes së subjektit të persekutimit të drejtëpërdrejtë në regjimin komunist.⁹

Gjithashtu, çojmë se edhe neni 8 i ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar” duhet të ndryshohet, duke u riformuluar në kuadër të përfshirjes të të gjithë radhëve të trashëgimtarëve, për arsye se bie në kundërshtim me parashikimet e dispozitave të Kodit Civil lidhur me përcaktimet e radhëve të trashëgimtarëve.

Më konkretisht, neni 8 përcakton:

“1. Në kuptim të këtij ligji, me familjarë nënkuptohen, pavarësisht nga rregullime të tjera ligjore, paraardhësit, bashkëshortja, pasardhësit, vëllezërit dhe motrat e ish të dënuarit politik,

si dhe fëmija/fëmijët e vëllezërve dhe motrave.

2. Familjarët, në shkallë më të parë, sipas Kodit Civil, përjashtojnë familjarët e tjerë.

3. Në rastin kur e drejta e përfitimit të dëmshpërblimit financiar përfundon me mbylljen e rrethit të familjarëve që nuk jetojnë, të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, dëmshpërblimi financiar, për pjesën takuese të tyre, kalon në buxhetin e shtetit.”.

Ndërkohë që në dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë parashikohen radhët e trashëgimtarëve ligjorë konkretisht në nenet 360, 361, 362, 363, 364. Përkatësisht në nenin 366 të këtij kodi sanksionohet se: “Kur trashëgimlënësi nuk ka lënë trashëgimtarë deri në shkallën e gjashtë, **thirret në trashëgim shteti.**”

Kështu që neni 8 duhet të ndryshohet, duke u riformuluar në kuadër të përfshirjes të të gjithë radhëve të trashëgimtarëve, që gjenden përpara shtetit, si dhe duke iu dhënë mundësinë e përfitimit të dëmshpërblimit.

Gjithashtu, nga trajtimi në vijimësi i çështjes së dëmshpërblimit të kategorisë së të përndjekurve politikë evidentojmë se nuk është kryer një transparencë totale mbi numrin e ish-të përndjekurve, të cilët ndër vite kanë tërhequr dëmshpërblimet. Ngrihen pyetjet: Sa është numri i atyre që nuk janë dëmshpërblyer dhe sa është numri i atyre që janë ndarë nga

⁹ Në nenin 6 të ligjit përcaktohet se:

Masa e dëmshpërblimit për të burgosurit, të internuarit ose të dëbuarit politikë do të jetë si më poshtë:

a) çdo i dënuar politik, **për çdo ditë vuajtjeje dënimi** të kryer, në burg, spital psikiatrik, spital burgu, izolim në hetuesi, nga data 30.11.1944 deri më 1.10.1991, dëmshpërblehet financiarisht, sipas kritereve të këtij ligji, në masën **2 000 (dy mijë) lekë** në ditë;

b) për personat që kanë vuajtur **internim** në kamp me rrethim me tela me gjemba deri në vitin 1954, masa e dëmshpërblimit është **1 000 (një mijë) lekë** në ditë;

c) për personat e tjerë të internuar ose të dëbuar parashikohet një skemë pensioni, e cila do të rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

jeta pa u dëmshpërblyer? Mendojmë se krijimi i një databaze të të dhënave të personave që kanë tërhequr dëmshpërblimet dhe fondi i buxhetuar, do të ndihmonte procesin.

Në këtë kuadër, do të kishim një tablo të qartë të situatës e cila kërkon ndjeshmëri dhe angazhim më të plotë të strukturave kompetente shtetërore, për të përmbushur me ritme më të shpejta detyrimin e njohur kësaj shtrese nga shteti shqiptar, por ende të pashlyer.

Për gjithë sa parashtruar, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”*, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*:

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të nevojshme për inicimin e nismës ligjore për ndyshimin dhe përmirësimin e ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 *“Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”*, i ndryshuar, me qëllim garantimin e të drejtës së dëmshpërblimit të ish përndjekurve/dënuarve politikë dhe familjarëve të tyre.
- Marrjen e masave të nevojshme për realizimin efektiv, të së drejtës për marrjen e kësteve të dëmshpërblimit për shtresën e ish të dënuarve/përndjekurve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre, duke rritur vlerën e fondit të miratuar për këtë kategori, si dhe duke planifikuar në mënyrë progresive pagesat për të realizuar këtë detyrim të paktën brenda një afati 10 vjeçar.
- Marrjen e masave për miratimin e VKM-së në zbatim të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 për miratimin e skemës së pensionit të veçantë për të internuarit dhe dëbuarit gjatë regjimit komunist.
- Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një databaze ku të përfshihen të dhënat e personave përfitues, të personave që kanë tërhequr dëmshpërblimet në vijimësi, fondi buxhetor përkatës, në kuadër të transparencës së procesit të dëmshpërblimit të kategorisë së ish të dënuarve politikë dhe pritshmërive për përmbylljen e tij në të ardhmen.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar lutemi na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA